

Shifra:0499 Ri.nr.11524/12

GJYKATA THEMELORE, DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM-DIVIZIONI PER KUNDERVAJTJE NE FERIZAJ, sipas gjyqtares Nazife Beqiri, me Sekretaren juridike Fatmire Mani, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehures Tevide Imerit nga Ferizaj, për shkak të kundërvajtjes nga neni 5,6 paragrafi 1.3 dhe neni 9 të Ligjit për Deklarimin e Prejardhjes dhe Kontrollit të Pasurisë së zyrtarëve të lartë public dhe deklarimin e prejardhjes dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë (Ligji nr.04/L-050), e në bazë të nenit 73, 74, 195 dhe nenit 199 të Ligjit Mbi Kundërvajtjet (ligj I aplikueshëm), më datën 13.09.2013 solli:

AKTVENDIM

E pandehura Tevide Ilmi Imeri e lindur më 03.05.1969 me vendbanim ne Ferizaj Rr. "Lulzim Guta"nr 05, e martuar, nene e 3 femijeve, delegate e Asamblesë Komunale të Ferizajt, student e Fak.Juridik, e gjendjes se mesme ekonomike, Shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës

Eshtë Përgjegjëse

Sepse, si delegate e Asamblesë së Komunës së Ferizajt, nuk ka vepruar sipas kërkeses se Agjencionit Kosovar Kunder Korrupsionit te dt.04.06.2012, pasi sipas Ligjit mbi Deklarimin e Prejardhjes dhe Kontrollin e Pasurise se zyrtareve te lartë publik dhe deklarimin e prejardhjes dhe kontrollin e dhuratave per te gjithe personat Zyrtare (Ligji nr.04/L-050), nuk e ka plotesuar formularin e ketij Agjensioni dhe nuk e ka deklaruar pasurine,

-me qka ka kryer kundervajtjen nga neni 17 par.1.3 te Ligjit per Deklarimin mbi Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise dhe Dhuratave te Zyrtareve te larte Publik(Ligji nr.04/L-050),

Andaj, ne baze te nenit 17 par.1.3 lidhur me nenin 5 al.1 te Ligjit mbi Deklarimin e Prejardhjes dhe Kontrollin e Pasurise dhe Dhuratave te Zyrtareve te larte Publik (Ligji nr.04/L-050), e në veshtrim te nenit 10 te LK, I shqiptohet

QORTIM

E pandehura obligohet qe ne emer te shpenzimeve te procedures kundervajttese te paguaj Shumen paushall prej 5 E, ne afat prej 15 ditesh nga dita e plotfuqishmerise se ketij aktvendimi.

Nga nje ekzemplare te ketij aktvendimi ju dergohet paleve

Arsyetim

Agjencioni Kosovar Kunder Korrupsionit ne Prishtine, ka parashtruar kerkesen nr. -01-2217/12 te dt.04.06.2012 per fillimin e procedures kundervajttese ndaj te pandehures Tevide Imeri nga Ferizaj, per shkak te kundervajtjes nga neni 5,6 par 1.3 dhe neni 9 te Ligjit mbi Deklarimin e Prejardhjes dhe Kontrollin e Pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin mbi prejardhjen dhe kontrollin e Dhuratave per te gjithe personat Zyrtare dhe ka propozuar qe I njehti te shpallet pergjegjes dhe te denohet sipas ligjit.

Gjyqtarja zhvilloi procedurën kundërvajtëse dhe e degjoi te pandehuren e cila ne mbrojtjen e

REPUBLIKA E KOSOVES	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT	
AGJENCIA PER TE LARTE PUBLIKE	
ADMINISTRACION AGJENTIA	
Dap.	Nr. Post
Dap. <u>DPK/DMP</u>	Emri <u>03-2929/13</u>
Dap.	Emri
Nr. I taq.	Emri
Broj. stranica <u>02</u>	Dati <u>23.08.2013</u>
Nr. pages	Dati
PRISHTINE	

vet dhene para kesaj gjykate me dt.02.10.2012 ka mohuar kundervajtjen qe I vihete ne barre dhe ka theksuar se e kam pare formularin per deklarimin e pasurise ne tavolinen e punes por askush nuk me ka njoftuar se si ta plotesoj dhe kujt t'ia dorezoj, por un e kam plotesuar te njejtin dhe e kam lene ne tavoline aty ku edhe e kam gjetur dhe une mendoj se e kam kryer obligimin tim per deklarimin e pasurise. Pasi jam njoftuar permes mediave kam shkuar ne AKK kam kerkuar sqarim pse nuk ka shkuar formulari te cilin e kam plotesuar ne kuvend dhe e kam plotesuar formularin tjeter prap dhe e kam dorezuar. Per vertetimin e gjendjes faktike gjyqtarja ftoi deshmitarin Naser Musa, zyrtar I pikes kontaktuese te Komunes se Ferizajt I cili ka theksuar se materialet bashk me formularet qe I ka pranuar nga AKK ju kanë shperndare bashk me Afrim Matoshin te gjithë keshilltareve dhe delegatëve te Komunes duke ua lene ne tavoline ne mbledhjen e dt.09.03.2012, e poashtu kanë qene te njoftuar edhe gojarishte (se duhet te plotesohen formularet) nga kryesuesi Agim Aliu (tash kryetar I Komunes se Ferizajt) dhe prezentoi ne Gjykate regjistrin e anëtarëve pjesmarres ne ate mbledhje. Nderkaq deshmitari tjeter Afrim Matoshi, zyrtar per mbarvajtje te KK Ferizaj theksoi se ju ka shpernda keshilltarve dhe deputetëve formularet per deklarimin e pasurise (pasi te njejtin I ka marre nga Naser Musa) duke ia lene secillit keshilltare ne ulese dhe te gjithë Deputetët kane qene prezent, perpos Makfire Sadikut.

Ne cilesinë e deshmitarit u ftua edhe perfaqesuesi I AKK Agron Behrami, I cile ne deklaraten e tij nder tjera theksoi se me hyrjen e ligjit te ri ne fuqi per deklarimin, prejardhjen e pasurise 04/L-050 kane per obligim qe edhe keshilltaret komunal ta bejne deklarimin e pasurise, ne pastaj nga pika kontaktuese kemi kerkuar nga Naser Musa te na dergoje listen e zyrtarve te larte qe kane per obligim deklarimin e pasurise nga K Ferizaj e ne pyetjen e gjyqtares theksoi se kerkesa te veqanta per deklarim te pasurise nuk u kemi derguar nga se kete nuk e parasheh ligji.

Gjate matjes se denimit u moren parasysh pesha e kundervajtjes, rrethanat ne te cilat eshte kryer kundervajtja, se nuk jane shkaktuar pasoja te renda, se eshte hera e pare qe I pandehuri ka kryer kundervajtje, se I pandehuri pasi ka kuptuar se ka qene I obliguar ta beje deklarimin e pasurise, e ka bere nje gje te tille, andaj u aplikua neni 10 I LK, me bindjen se edhe me kete lloj denimi do te arrihet qellimi ndeshkimor, qe ne te ardhmen te mos kryeje vepra te ketilla apo te ngjashme.

GJYKATA THEMELORE, DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM – DIVIZIONI PER KUNDERVAJTJE NE FERIZAJ

**Sekretarja juridike
Fatmire Mani**



KESHILLA JURIDIKE:

Kunder ketij aktvendimi te pandehurit dhe parashtruesit

Te kerkeses iu lejohet ankesa ne Gjykatën e Apelit – Divizioni per Kundervajtje

**ne Prishtine, ne afat prej 8 ditesh, pas marrjes se ketij aktvendimi,
permes kesaj Gjykate**